



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Sigurinë Kombëtare***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 25.09.2018, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës :**

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 18.09.2018.
2. Shqyrtim i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar”.

**Marrin pjesë:**

Ermonela Felaj, Spartak Braho, Milva Ekonomi, Luan Duzha, Luan Harusha, Elona Hoxha, Paulin Sterkaj, Xhemal Qefalia, Vullnet Sinaj dhe Pjerin Ndreu.

**Mungojnë:**

Sadi Vorpsi, Andon Frrokaj, Anduel Xhindi, Isuf Çelaj, Ervin Salianji, Flamur Noka, Luan Rama, Xhemal Gjunkshi, Myslim Murrizi dhe Endrit Braimllari.

**Të ftuar:**

Vasilika Hysi – Deputete

Ëngjëll Hysi - Drejtor i Shërbimit të Provës

Erion Semani –Drejtor Juridik i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve

## HAPET MBLEDHJA

**Ermonela Felaj** – Mirëmëngjesi!

Hapim mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare.

Sot në rendin e ditës kemi parashikuar miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 18.09.2018. Ka ndonjë vërejtje nga kolegët për procesverbalin? Nuk ka.

Miratohet.

Kemi edhe shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar. Ju kujtoj se ky projekt është pjesë e paketës së ligjeve për reformën në drejtësi.

Për të prezantuar këtë projekt, ndryshimet që propozohen në ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale” kemi të ftuar kolegen, zonjën Vasilika Hysi.

Faleminderit, zonja Hysi, për prezencën tuaj!

Gjithashtu kemi të ftuar drejtorin e Shërbimit të Provës, zotin Ëngjëll Hysi dhe zotin Erion Semani, drejtor Juridik i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, meqenëse dihet se ligji funksional për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve është ligji “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Po e fillojmë me zonjën Hysi për prezantimin e projektit në fjalë. Relator nga ana e komisionit tonë është caktuar zoti Xhemal Qefalia.

Zonja Hysi, fjala është për ju.

**Vasilika Hysi** - Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë dhe kolege, sikurse e përmendi edhe kryetarja e Komisionit ne kemi filluar shqyrtimin e projektligjeve që janë

Ky ligj, i cili propozon disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, ishte paketë me ligjin “Për shërbimin e provës” që nuk ishte pjesë e punës së grupit të ekspertëve të nivelit të lartë për reformën në drejtësi, por ishte nismë e qeverisë, njëkohësisht edhe me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e personave të paraburgosur dhe të dënuar”, i cili ende nuk ka ardhur që të fillojë diskutimi.

E bëra këtë parantezë për të theksuar që të 3 këto projektligje duhen parë në paketë, pasi kanë ndikim te njëri-tjetri dhe janë të lidhur organikisht me njëri-tjetrin.

Nga ana tjetër, me propozimin e këtij projektligji do të kërkoja nga ju të nderuar kolegë, që jeni profesionistë në këtë fushë të kemi parasysh edhe ndryshimet që janë bërë në

Kodin e Procedurës Penale, në ligjin “Për prokurorinë”, ndryshimet që janë bërë në Kodin Penal, por edhe Kodi i ri i të Miturve, i cili ka filluar të zbatohet në vendin tonë.

Shumë shkurt dua të evidentoj disa nga problematikat që janë konstatuar në praktikë, për të cilat u propozua kjo nismë, që është produkt i punës së ekspertëve të nivelit të lartë. Unë vetëm kam ushtruar të drejtën kushtetuese, e kam firmosur për ta depozituar para Kuvendit të Shqipërisë.

Çështja e parë ose problematika ka të bëjë me njoftimin e të dënuarve, të cilët janë hetuar dhe gjykuar në gjendje të lirë dhe duhet të bëhet ekzekutimi vullnetar i tyre. Praktika ka evidentuar një sërë problemesh për paraqitjen e tyre për të filluar vuajtjen e dënimit për njoftimin.

E dyta lidhet me personat për të cilët është vendosur masa e sigurisë “arrest në shtëpi”. Ju e dini dhe kush ka punuar në këto institucione e ka kuptuar vështirësinë që haset në mbikëqyrjen e personave, për të cilët gjykata ka dhënë “arrest në shtëpi” dhe për mënyrën e kontrollimit të sjelljes së tyre, me qëllim që në fund të ketë një politikë penale të aplikuar nga gjykata sa më të drejtë.

E treta lidhet me rolin që luan Shërbimi i Provës në mbikëqyrjen e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, që nuk ka qenë aspak e qartë, duke pasur parasysh edhe një vështirësi që Shërbimi i Provës është një shërbim i ri i krijuar në vitin 2009 dhe deri sot që flasin rregullohet me një vendim të Këshillit të Ministrave, vendimin nr. 323 dhe projektligji ende nuk është miratuar në Kuvendin e Shqipërisë. Në legjislaturën e kaluar patëm një diskutim, ka pasur konsultim publik, projekti është gati, u tërhoq nga qeveria, nga Ministria e Drejtësisë dhe do të ishte mirë që të ishte paraqitur.

E fundit fare është koha e fillimi të vuajtjes së dënimeve alternative. Një nga risitë e Kodit Penal është politika më humane jo mbipopullimi i burgjeve, por zbatimi i dënimeve alternative. Të zbatosh një dënim alternativ, nuk do të thotë që të lësh të dënuarin të lirë, pa mbikëqyrje, pa përmbushur disa detyrime, por kërkohet një mbikëqyrje jo thjesht për të vlerësuar sjelljen e tij, por mbi të gjitha për të parandaluar ripërsëritjen e krimit, pra rifutjen e tij në krim.

Koha e fillimit të vuajtjes së dënimit shpesh ka qenë një debat dhe një problematikë e ngritur edhe në Komisionin e Ligeve, kur kanë raportuar qoftë Prokurori i Përgjithshëm, apo kur kemi diskutuar pjesë të tjera të ligjit, pasi është mundësia më e madhe për një aferë korruptive, që personi të mos paraqitet në kohën e duhur, por të paraqitet një javë para se të përfundojë periudha e dënimit. Pra, që nga momenti kur është dhënë dënimi i formës së

prerë dhe deri në momentin kur personi paraqitet mund të jetë një periudhë relativisht e gjatë dhe realisht i dënuari nuk vuan aspak ose nuk ekzekuton asnjë nga detyrimet që lidhen me vuajtjen e dënimeve alternative.

Këto probleme të vëna në dukje në Dokumentin Analitik të sistemit ë drejtësisë janë pasqyruar në projektligj.

Të nderuar kolegë, ky projektligj, sikurse e thashë është paketë me ligjet e tjera, por unë jam e hapur për të pranuar çdo sugjerim, rekomandim apo amendamente që ju mendeni për ta përmirësuar projektligjin e depozituar dhe për ta bërë atë më efektiv, duke pasur parasysh edhe problematikat që mund të ketë nxjerrë në praktikë zbatimi i Kodit të ri të Procedurës Penale, zbatimi i kodit të drejtësisë penale për të miturit, por edhe probleme të tjera për të cilat punonjësit e praktikës janë më kompetentë se ne.

Gjithashtu, në përfundim të fjalës sime do të doja të shihnim edhe nëse ka nevojë për të pasur një dispozitë të veçantë, të cilën në projekt ne nuk e kemi vënë për aktet nënligjore, pra, nëse ka nevojë për akte nënligjore për të rregulluar më mirë komunikimin midis institucioneve lidhur me ekzekutimin e vendimeve penale.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Hysi!

Kujtoj që Komisioni i Sigurisë Kombëtare është komision vetëm për dhënie mendimi për këtë projektligj, por referuar *background* -it të një pjese të mirë të anëtarëve të këtij komisioni besoj se do të jemi në gjendje të japim mendime të vlefshme, të cilat do të mund ta përmirësojnë në maksimum ligjin.

Natyrisht, ne mund të kishim thirrur edhe përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme, meqenëse ligji paraqet ndryshime të tilla që nuk lidhen thjesht dhe vetëm me punën e shërbimit të provës, por edhe ndryshime të tjera që lidhen edhe me punën e organit të prokurorisë, që është organi i cili nxjerr urdhrin e ekzekutimit dhe përcakton të gjitha dertimet përkatëse për të dënuarin ndaj të cilit është dhënë një dënim dhe duhet të vuaj këtë dënim.

Megjithatë, ne sot kemi drejtorin e Shërbimit të Provës dhe drejtorin juridik të Policisë së Burgjeve. Besoj se diskutimi me ta do të na ndihmojmë të kuptojmë nëse ndryshimet e propozuara janë të tilla që i reflektojnë të gjitha nevojat e punës.

Më herët, Komisioni i Sigurisë ka qenë në një vizitë në Shërbimin e Provës. Ne kemi pasur kontakt në drejtuesin dhe nëpunës të tjerë të atij institucioni dhe, natyrisht, jemi njohur me disa shqetësime të tyre.

Personalisht, mund të them se kam parë që një pjesë e atyre gjërave janë reflektuar në këto propozime, gjithsesi fjala është për zotin Hysi.

Faleminderit, për prezencën tuaj!

**Ëngjëll Hysi** – E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj për ftesën dhe mundësinë që më jepni për të shprehur disa mendime që rregullojnë punën dhe veprimtarinë e Shërbimit të Provës.

Sikundër e tha edhe zonja kryetare, Komisioni i Sigurisë ka pasur një vëmendje të posaçme për Shërbimin e Provës si një institucion relativisht i ri dhe që ka ende ka nevoja për të zgjidhur.

Për sa i përket projektligjit të ardhur unë kam disa mendime të cilat shpresoj se do të merren në konsideratë dhe të na ndihmojnë për përmirësimin e këtij projektligji.

Për sa i përket nenit 24 mendoj se, pasi themi “arrest shtëpie apo detyrim paraqitjeje” të bjerë pjesëza “apo” dhe pas “detyrim paraqitjeje” të shtohet “apo të dënuarit me dënime alternative”, sepse shtrohet pyetja “Po të dënuarit me dënime alternative kush do t’i njoftojë në rast se ato nuk vijnë vullnetarisht ose nuk paraqiten pasi ne i çojmë një njoftim nëpërmjet postës? Pra, mendoj që të përfshihet si detyrim i Policisë së Shtetit, jo vetëm për të dënuarit apo ata me arrest, por edhe të dënuarit me dënim alternativ. Ky është një rregulli për të shtuar edhe të dënuarit me dënim alternativ.

Për sa i përket nenit 31/4, paragrafi II, më lejoni t’ju bëj një parantezë të shkurtër. Ligji nuk e ka rregulluar se si një i dënuar me qëndrim në shtëpi mund të ndërrojë banesë. Ne kemi pasur në praktikë disa raste, të cilat e kemi pasur të pamundur t’i zgjidhim, se nuk ka asnjë rregullim ligjor.

Pra, ideja është që një të dënuari me qëndrim në shtëpi, gjykata i ka vënë detyrimin që ai të vazhdojë shkollën, ndërkohë ai shkollën nuk e ka në Vlorë, por e ka në Tiranë. Si i bëhet në këto raste, kur përplasen detyrimi i gjykatës me pamundësinë e ndërrimit të banesës?

Propozimi ynë është që te neni 31/4, pas paragrafit të dytë të shtohet një paragraf tjetër ku të rregullohet në mënyrë ligjore që i dënuari me qëndrim në shtëpi ka të drejtë të ndërrojë banesën duke iu drejtuar Shërbimit të Provës, prokurorisë ose gjykatës, por duhet të jenë këto organe që pastaj e rregullojnë.

Shërbimi i Provës në këtë rast merr detyrimin të hartojë një raport vlerësimi për faktet, për kushtet, për gjendjen se pse ai kërkon të ndërrojë banesë. Pra, të drejtën për të kërkuar ndërrimin e banesës ta ketë i dënuari, organi verifikues të jetë shërbimi i provës dhe

vendimmarrësi të jetë gjykata se ajo ka dhënë vendimin, adresën dhe banesën ku ai do të vuajë dënimin.

Mbase unë nuk jam i gatshëm sot për të formuluar, por mendoj të shtohet një paragraf i posaçëm për këtë.

Te neni 31/9 ka një vend që duhet saktësuar, aty ku themi “gjykatësit ose vetë prokurorit”, në kllapa. Mund ta lemë gjykatësit ose prokurorit, por nuk e di a qëndron apo jo në kllapa.

Unë mendoj se duhet ta ketë edhe prokurori për efekt kohe, sepse e kërkojnë afatet e dënimit në bazë të ndryshimit që ka pësuar Kodi Penal vjet. Neve na kanë ardhur të dënuar edhe me një muaj shërbim prove, edhe me 28 ditë shërbim prove. Në rast se ne i hyjmë procedurës, që duhet t’i venë prokurorit, prokurori t’ia çojë gjykatës, gjykata të ndjekë hapësirat procedurale, duhet të jetë edhe në kompetencë të prokurorit që ai të vendosë të shtyjë afatin e vuajtjes së dënimit.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Ne do të kemi rast edhe gjatë shqyrtimit nen për nen që t’i reflektojmë të gjitha sugjerimet tuaja, sigurisht nëse gjejmë edhe konsensusin e anëtarëve të këtij komisioni.

Dakord. Këto janë ndërhyrjet tuaja për projektin në fjalë.

Ndërkohë, do të doja të dëgjonim edhe zotin Erion Semani për qëndrimin e organit tuaj në lidhje me këtë propozim që kemi përpara.

**Erion Semani** - Faleminderit!

E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj për ftesën dhe për vlerësimin që na është bërë! Si përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve mendoj se ndryshimet përkatëse në projektligj do të ndihmojnë në punën tonë për përditshme, duke u nisur nga disa problematika që ne kemi pasur në lidhje me këto dispozita, konkretisht, ndryshimi që është bërë në nenin 39, paragrafi i dytë i ligjit, kur për të dënuarin që ka pasur dënim kryesor burgimin, nxjerrja jashtë territorit ekzekutohet nga Policia e Burgjeve, menjëherë pas përfundimit të dënimit kryesor.

Ndryshimi është shumë i domosdoshëm dhe i nevojshëm, konkretisht kur bëhet ndryshimi “në bashkëpunim me drejtorinë e migracionit”, të cilët marrin masa përkatëse për nxjerrjen e të dënuarit jashtë territorit menjëherë pas përfundimit të dënimit kryesor dhe kur

kjo nuk është e mundur të realizohet, menjëherë e dërgon atë në një vend të përshtatshëm, derisa të plotësohen kushtet për largimin e tij nga territori.

Pra, meqenëse Policia e Burgjeve, e nderuar zonja kryetare dhe të nderuar anëtarë, ka gjithmonë një orientim në rastet e përcaktuara nga gjykata apo në rastet e ekstradimit, kur e nxjerr jashtë territorit. Në rastet e ekstradimit, ne kemi gjithmonë bashkëpunim me zyrën e Interpolit. Ata na përcaktojnë edhe kohën kur do të dalë. Kështu, mendoj se ky ndryshim është shumë i domosdoshëm, që Drejtoria e Emigracionit, pranë Ministrisë së Rendit, në rastin konkret do të orientojë edhe vendin edhe kohën e daljes që personit në fjalë, shtetasi i huaj, si dhe ku do të akomodohej pas daljes.

Unë desha një saktësim në lidhje me fjalët: “jashtë territorit”, në qoftë se nënkuptohet: “jashtë territorit të vendit”, pra të Republikës së Shqipërisë. Pra, thjesht një saktësim. Mos duhet bërë: “jashtë territorit të vendit” apo “jashtë Republikës së Shqipërisë”. Kjo është.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ermonela Felaj** – Faleminderit për ndërhyrjen tuaj, zoti Semani!

Kuptohet se ndërhyrja juaj do të ishte e tillë, domethënë, nen për nen. Me sa kuptohet nga fjala juaj, parimisht, duket se të dyja institucionet janë dakord dhe besojnë se ky projekt i përmbush nevojat e tyre. Sidoqoftë, në lidhje me këtë projekt do të doja të dëgjonim edhe relatorin. Më pas do të kemi pyetje nga kolegët.

**Xhemal Qefalia** – Faleminderit, zonja kryetare!

Një falënderim shkon posaçërisht për zonjën Hysi, e cila si një eksperte e aftë dhe e zonja për sa i përket pjesës penale, por njëkohësisht do të doja ta evidentoja edhe për vetë misionin dhe rolin që ka luajtur, kryesisht në lidhje me respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Kalimi i këtij projektligji në komisionin tonë, të nderuar kolegë, ka rëndësi të veçantë, sepse kryesisht ka të bëjë me ruajtjen e sigurisë publike. Trajtimi i këtij drafti në komision duhet të fokusohet pikërisht në këtë gjë, pasi ky është një kontingjent i cili ka marrë një masë dënimi, një alternativë të dënimit penal. Në këtë kuadër, në lidhje me kohën aktuale që ka kryer, është parë nga vetë Komisioni i Sigurisë, por kryesisht nga Shërbimi i Provës, me përvojën e re që ka në këtë drejtim, arsye për të cilën merr rëndësi të veçantë. Gjatë kësaj kohe ka evidentuar edhe problematikat që u përmendën nga zonja Hysi, por që unë do të doja t'i trajtoja në mënyrë të shkurtuar.

Problematikat kanë qenë si më poshtë:

Ka pasur vështirësi për sa i përket mënyrës së njoftimit të të dënuarve, të cilët gjatë ekzekutimit vullnetar dhe fazës së hetimit apo gjykimit, kanë qenë në gjendje të lirë, apo mbas sigurimit të arrestit në shtëpi.

Së dyti, një vështirësi e evidentuar është edhe mbikëqyrja nga Shërbimi i Provës i personave në masë sigurie arrest në shtëpi.

Një tjetër vështirësi e evidentuar është ekzekutimi i vendimeve në rastet kur dënuari, siç u përmend edhe nga drejtori i Shërbimit të Provës, ka ndryshuar adresën e vendbanimit.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, duhet pasur në konsideratë fakti se politika penale, sidomos me reformën në drejtësi, ka pësuar një hov cilësor për sa i përket alternativave të dënimit. Kështu, në këtë kohë është evidentuar edhe një mangësi, një shkelje për sa i përket përcaktimit se kur duhet të fillojë koha e vuajtjes së dënimit.

-Në këtë kuadër, në mënyrë të shkurtuar dhe pa u vonuar shumë, do të doja të evidentoja se objekt i reformës në drejtësi është pikërisht rritja e efektivitetit të sistemit të drejtësisë penale, që në këtë rast synon përmirësimin e kuadrit ligjor në lidhje me ekzekutimin e masave edukuese e mjekësore, si dhe krijimin e institucioneve të posaçme për ekzekutimin e këtyre masave.

-Së dyti, në garantimin e ekzekutimit të drejtë dhe të njëjtë të vendimeve gjyqësore dhe në respektimin e parimit të lirisë dhe të sigurisë së personit.

-Së treti, i jep një rol jo pak të rëndësishëm, sepse ridimensionon rolin e gjykatës e të prokurorit në ekzekutimin e vendimeve penale, duke synuar rritjen dhe efektshmërinë e sistemit të ekzekutimit.

-Një aspekt tjetër i rëndësishëm në këtë kuadër, ka të bëjë me zhvillimin e sistemit të burgjeve, bazuar në harmonizimin e vazhdueshëm me standardet ndërkombëtare dhe krijimin e kushteve të nevojshme për zbatimin e tyre.

-Së fundi, në krijimin e mekanizmave ligjorë dhe institucionalë, të pajisur me burime të nevojshme materiale e njerëzore për trajnimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm profesional të stafit, të administratës dhe institucioneve penitenciare të Shërbimit të Provës.

Nisur nga rëndësia që ka ky ligj, por edhe nga mendimet e kolegëve, unë mendoj që ky ligj të kalohet nga komisioni ynë për te Komisioni i Ligjeve, si komision përgjegjës, për të parë edhe teknikën legislative apo nene të veçanta, të cilat do të propozohen nga ne.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Qefalia!

Tani është radha e pyetjeve nga kolegët, në lidhje me projektin në fjalë, për zonjën Hysi, e natyrisht edhe për të ftuarit e tjerë.

Ka pyetje nga kolegët?

Zonja Gjebrea ka një pyetje.

**Elona Gjebrea** – Faleminderit!

Edhe unë dëshiroj të falënderoj deputeten Hysi në lidhje me këtë iniciativë kaq të domosdoshme, sikurse u theksua edhe nga relatori e drejtori.

Në fakt, më shumë e kam sugjerim. Këtu u përmend Drejtoria e Emigracionit. Drejtoria e Emigracionit në Ministrinë e Brendshme nuk është e njëjtë me Drejtorinë e Emigracionit në Policinë e Shtetit, për të cilën unë mendoj se e keni fjalën. Mendoj se kjo duhet përcaktuar, sepse janë dy drejtori me të njëjtin emër. Kjo ishte thjesht për saktësim.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Ka pyetje të tjera?

Po, zoti Sina.

**Vullnet Sina** – Unë jam plotësisht dakord me këtë ligj, sepse shikoj se këto ndryshime që kërkojmë të bëjmë vijnë si rezultat i pengesave që kanë hasur në punën e përditshme Policia e Burgjeve, por edhe Shërbimi i Provës.

Unë kisha një pyetje për drejtorin juridik të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, zotin Erion Semani. Është pak fare jashtë temës. Ka raste të personave, që gjykata i shpall të papërgjegjshëm, dhe si rezultat pushon gjykimin e çështjes, duke marrë një vendim, sipas të cilit këta duhet të bëjnë një mjekim të detyrueshëm në institucionin mjekësor ose ambulator. Në rastin kur gjykata merr vendim që këta të bëjnë një mjekim të detyrueshëm në institucion mjekësor, çfarë bëhet? Është ngritur ky institucion i specializuar mjekësor për këta të sëmurë apo i mbajmë akoma nëpër spitalet e burgjeve?

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Po, zoti Semani!

**Erion Semani** – Për sa u përket rasteve për të cilat pyesni ju, i nderuar deputet, pra në lidhje me këta persona, aktualisht, në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, për personat që janë me vendim nga gjykata, me shtrim të detyrueshëm në spital psikiatrik (pasi mjekimi ambulator bëhet kur ata lirohen dhe jetojnë të lirë), aktualisht, kemi institucionin e IEVP-së të shërbimeve penale në Krujë, ku ka mjekë të specializuar për fushën përkatëse të psikiatrisë, kur janë raste të shtrimit të detyrueshëm në spital psikiatrik.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, si dhe me hapjen e institucionit të vendimeve penale të Shkodrës, 2 godina ku do të evakohen të dënuarit nga Lezha në Shkodër do të bëhen spitale me mjekim më të specializuar. Në vijimësi të pyetjes suaj, aktualisht këta persona janë në spitalin e IEVP-së, që është IEVP penale, por që ka mjekë të specializuar të fushës për psikiatrinë. Aty i mbajmë këta persona.

**Ermonela Felaj** – Po, nëse nuk e morët të plotë përgjigjen e pyetjes suaj, mund të vijoni.

**Vullnet Sinaj** – Mora një përgjigje, por do të kërkoja nga drejtori të vazhdojë t'i kërkojë Ministrisë së Drejtësisë që kjo çështje të zgjidhet, sepse nuk është e drejtë që këta persona, këta qytetarë, të mbahen në spitalin e burgut dhe të trajtohen atje, por duhet të ketë një institut të veçantë për ta.

Unë kam informacion që shpeshherë kemi vërejtje për qeverinë shqiptare, që nuk i ka marrë këto masa.

Do të kërkoja nga ju, si drejtor juridik i burgjeve, t'i bëni kërkesa të vazhdueshme Ministrisë së Drejtësisë, që të zgjidhet ky problem, sepse kemi qytetarë që kanë probleme dhe nuk janë në spital dhe në institucionet përkatëse, por duket sikur vuajnë dënimin duke qëndruar në spitalet e këtyre burgjeve. Ky është një problem shqetësues për të gjithë.

Unë kam pasur raste të tilla në zonën time dhe dua t'i mbështes ata qytetarë dhe të kërkoj drejtësi. U informova që ky është një problem shumë shqetësues për shoqërinë tonë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Sinaj!

Në fakt, pyetja juaj lidhet me një çështje shumë të debatuar prej vitesh dhe nuk është një çështje e re, të paktën për të gjithë aktorët e drejtësisë penale.

Bëhet fjalë për masat mjekësore dhe edukuese, të cilat nuk zbatohen, jo për faktin se nuk përshkruhen në ligj, sepse ligji i përshkruan saktësisht dhe, natyrisht, detyrimi për t'i zbatuar ato është i prokurorisë, sepse për çdo vendim dënimi ose jo i tillë, vendimet e gjykatës janë vendime që ekzekutohen nëpërmjet urdhrave që nxjerr prokuroria. Në fakt, kanë munguar institucionet përkatëse, që të bënin trajtimin e këtyre personave.

Megjithatë, çështja që ju ngritët është absolutisht shumë e ndjeshme. E thashë edhe një herë, për prokurorët dhe gjyqtarët është shumë problematike vënia në zbatim e këtyre lloj masave.

Mendoj se si Komision Sigurie na takon të thërrasim në një seancë të posaçme ministrin e Drejtësisë dhe ministren e Shëndetësisë, për të kuptuar se çfarë është bërë në këtë drejtim dhe cila pritet të jetë e ardhmja e këtyre personave.

Faleminderit!

Kalojmë te diskutimet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ka një pyetje përpara se të kalojmë te diskutimet.

Zoti Braho ka fjalën më pas.

**Paulin Sterkaj** – Kam një pyetje për nënkryetaren e parlamentit. Sa e ka koston financiare ky projektligj, se...?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, i nderuar koleg!

Ky projektligj nuk ka kosto financiare, por ka thjesht rregullim procedurash dhe komunikimi midis institucioneve, sepse janë po ata punonjës që punojnë, por në rast se sot është luajtur ping-pong se kush duhet ta njoftojë, policia, prokuroria, organet e qeverisjes vendore apo Shërbimi i Provës, me këtë ligj përcaktohet qartë se cili është organi kompetent që duhet ta kryejë dhe se çfarë duhet të kryejë.

Mendoj se pjesa më e madhe e problematikave që ka hasur Shërbimi i Provës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, mund të zgjidhet me këtë ligj, por jo vetëm. E ritheksova edhe një herë, ne kemi në proces për të rimarrë ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës.” Ka pasur edhe një debat, zonja kryetare dhe ju të nderuar kolegë, nëse ai ligj do të ishte thjesht një ligj për organizimin dhe funksionimin e institucionit apo do të hyjë edhe në çështjet e funksioneve të përmbajtjes? Unë sot nuk jam në gjendje të kthej një përgjigje, sepse është Ministria e Drejtësisë, e cila do ta japë atë, por ndoshta do të ishte mirë që Ministria e Drejtësisë të ishte e pranishme dhe të na jepte një vlerësim, nëse projektligji që do të depozitojë për Shërbimin e Provës, do të jetë projektligj që do të merret me organizimin dhe funksionimin, me mënyrën se si do të rekrutohet stafi dhe strukturat apo do të hyjë edhe në përmbajtje, për të adresuar një sërë shqetësimesh?

Gjithashtu, nëse do të më lejoni, zonja kryetare, doja të jepja një mendim për shqetësimin shumë të drejtë që ngriti kolegu Sinaj. Është një problem i pazgjidhur.

Kemi miratuar ligjin “Për shëndetin mendor” në vitin 2012. Ka gati 6 vjet që të dyja ministritë po punojnë së bashku për të ngritur qendrën e re. Në dijeninë time, po punohet për ta bërë në Lezhë qendrën, për të ngritur një institucion të posaçëm, sepse nuk duhet të jetë

pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, por duhet të jetë pjesë e Ministrisë dhe Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe vetëm rrethimi i jashtëm duhet të jetë pjesë ose kompetencë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Ne kemi parashikuar një seancë dëgjimore te Nënkomisioni i të Drejtave të Njeriut. Meqenëse vullneti juaj është shumë i mirë dhe këtu ka ekspertë që kanë kontribuar dhe kanë drejtuar institucionet, qoftë të burgjeve, qoftë të policisë, qoftë për çështje të sigurisë e të tjerë, mund të ishte një seancë dëgjimore e përbashkët. Të them të drejtën, në kalendarin që ne kemi diskutuar në komisionin tonë dëgjesa është planifikuar për muajin tetor, por do të ishte shumë mirë të kishim një dëgjese të përbashkët për të adresuar këto shqetësime, pse jo duke ftuar edhe përfaqësuesit e organeve vendore dhe të institucioneve të tjera ligjzbatuese, që gjithsecili të marrë përgjegjësitë, por njëkohësisht, nëse ka nevojë për ndërhyrje të tjera ligjore në paketën e ligjeve që pritet të vijnë apo pas dy muajsh kur të vijë buxheti, të dimë se cili do të jetë fondi i nevojshëm që duhet alokuar për institucionet dhe për zgjidhjen e këtij problemi, që është shumë i madh dhe është shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut. Jemi dënuar nga Gjykata e Strasburgut. Kemi një raport të CPT-së dhe disa detyrime që na janë lënë për t'i përmbushur.

Ju falënderoj edhe për kujdesin që keni treguar në zonën ku jeni zgjedhur deputet!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Besoj se mund t'i bashkohemi Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut, aq më tepër që ditët e fundit edhe nga media është bërë shqetësim publik një shifër relativisht e lartë: 3 mijë vetë të shtruar përgjatë 1 viti vetëm për probleme të shëndetit mendor. Kështu që bëhet shumë evidente çështja e institucionit ku duhet të trajtohen personat e tillë, por që kryejnë vepra penale, sepse, natyrisht, këto kemi si subjekt trajtimi dhe nuk kemi të gjithë personat që kanë probleme.

Po, zoti Braho.

Fjala është për ju për diskutim.

**Spartak Braho** – Faleminderit!

Edhe unë do të të falënderoj, zonja Hysi, për merakun e madh që ke treguar për të sjellë këto ndryshime, por edhe sepse ke marrë kurajën të korrigjosh e të ndryshosh një ligj, që i takon periudhës së Ramiz Alisë, apo jo?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është i '88-ës.

**Vasilika Hysi** – Është i '98-ës.

**Spartak Braho** – Atëherë duhet korrigjuar.

Ligji dhe ndryshimet e paraqitura janë të domosdoshme, por vijnë edhe si një merak, si një parregullsi dhe si një problematikë e madhe që has Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Shërbimi i Provës.

Të gjitha ndryshimet janë të justifikuara, por duhet parë, sepse mjaft prej ndryshimeve të propozuara kanë formën e rregullores. Unë do të isha i prirë, sepse që nga viti 1998 ne nuk kemi më as ligj, nuk e kemi rinovuar ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, madje nuk kemi as akte nënligjore.

Në qoftë se do të ishim më të duruar, por unë do ta mbështes iniciativën tuaj, e mira do të ishte që të gjitha ndryshimet, që nuk kanë të bëjnë me veprimtarinë e gjykatave dhe të prokurorisë këtu, të ishin pjesë e parashtrimit në aktet nënligjore që duhet të nxjerrë Këshilli i Ministrave. Megjithatë, le t'i shkojmë deri në fund, nisur edhe nga detyrimi që kemi për ta riparë ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, le ta përmirësojmë atë në mënyrë totale.

Në nenin 1 ose në nenin 24 të ligjit të vjetër, rreshti i fundit, thuhet: “Këtë njoftim e realizojnë nëpërmjet autoriteteve përkatëse vendore”. Unë dua të di, cilat janë këto? Unë do të thosha që ne duhet të ngulemi tek inspektori i policisë, se nuk merren lagjet me këtë punë.

Inspektori i policisë duhet të bëjë njoftimin përkatës, dhe ky është mendimi im, ku i dënuari ka vendbanimin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Inspektori i lagjes.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ose punonjësi i policisë, nuk e di si...

Neni 3, ose paragrafi 6 i nenit 31, lidhet përsëri me një hallkë që e ka shërbimi i provës kryesisht, ku thuhet: “Personi i liruar me kusht synon të ndryshojë vendbanimin...”, dhe “...detyrohet të njoftojë paraprakisht Shërbimin e Provës”. Po kur nuk e bën këtë njoftim, çfarë ndodh? Ja nuk e bën ai, çfarë ndodh? Se nuk i japim rrugë deri në fund...

Jam dakord që shërbimi i provës njofton në lidhje me ndryshimin e vendbanimit organet e policisë, prokurorinë, por kur personi i dënuar nuk e bën vullnetarisht këtë, se bëjmë një deklaram këtu, ama nuk gjen rrugëzgjidhje të plotë. Këtë e preku drejtori i Shërbimit të Provës, pra është gjykata ajo që e cakton afatin e fillimit të vuajtjes së dënimit, dhe kjo thuhet te neni 4.

Neni 6 duhet plotësuar, sepse kur thuhet: “Nxjerrja jashtë territorit të vendit”, në qoftë se është fjala..., duhet bërë ai plotësim.

*(Diskutime në sallë)*

Te neni 7, Vasilika, e keni tri herë fjalën “ekzekutim” në dy rreshta. Kur bëhet ekzekutimi, bëhet nga Policia e Shtetit për ekzekutimin e vendimit. Pra, për sa i përket teknikës legislative, duhet saktësuar.

Çështja e fundit që kam është se ne duhet t’i shoqërojmë. Unë nuk e kam parasysh kush e ka sjellë këtë ligj në vitin 1998, nëse ka qenë Ministria e Drejtësisë ose jo, por duhet përcaktuar...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mirë, por ne duhet të vëmë patjetër aktet nënligjore.

Për shembull, unë them se nenet 2, 6 dhe 7 të ndryshimeve të tanishme duhet të jenë pjesë e zbërthimit me akte nënligjore.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Braho!

A ka diskutime të tjera nga kolegët para se të kalojmë te miratimi në parim? Nuk ka.

Para se të kalojmë në votim, zonja Hysi kërkon fjalën për një ndërhyrje.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zonja kryetare!

Shumë faleminderit, zoti Braho për komentet dhe sugjerimet tuaja!

Në fakt, ka pasur një diskutim në Komisionin e Reformës në Drejtësi për të pasur një ligj të ri për ekzekutimin e vendimeve penale, meqenëse janë bërë shumë ndryshime në Kodin e Procedurës Penale, si dhe kemi një Kod të Drejtësisë Penale për të Miturit, madje ky ka qenë edhe propozimi im personal.

E dyta, kemi pasur një debat dhe një diskutim për të pasur një ligj të ri për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar, sepse ai daton prillin e vitit 1998, para miratimit të Kushtetutës. U tha se do t’i sillte qeveria, por për atë kohë sa ne nuk kemi dy ligje të reja dhe kemi një sërë problematikash në praktikë, unë pajtohem me vlerësimin dhe qëndrimin tuaj për t’i kaluar këto ndryshime, duke i rekomanduar Këshillit të Ministrave të ngrejë një grup pune dhe të hartojë ligjin e ri për trajtimin e të drejtave të të dënuarve, pasi nuk mund të kemi një ligj që është para miratimit të Kushtetutës, ndërkohë që në vitin 2006 Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës ka miratuar rregullat e reja europiane për burgjet, pra ai ligj ka ndryshuar disa herë dhe normalisht është bërë pothuajse shtojca e shtojca.

Lidhur me rekomandimet tuaja për çdo nen, unë i mbajta shënim dhe jam absolutisht dakord, pra nuk kam asgjë kundër.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Hysi!

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale””.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në diskutimin nen për nen të projektligjit.

Ftoj kolegët të shprehen nen për nen, nëse kanë ndonjë qëndrim ndryshe nga sa u tha deri tani këtu, me qëllim që të mund ta bëjmë detyrën tonë siç na ka takon.

Fillojmë me nenin 1, që ndryshon nenin 24 të projektligjit. Ftoj kolegët të shohin dokumentin e përgatitur nga stafi i komisionit, ku i keni të dyja variantet: siç është ligji aktualisht dhe si propozohet të ndryshojë në disa nene të tij.

Pjesa me të zezë të theksuar është pjesa që propozohet të ndryshojë.

Nuk e di, a ka ndonjë vërejtje nga kolegët më parë, përveç atyre që u thanë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Fjalën e ka zoti Hysi për një ndërhyrje.

**Ëngjëll Hysi** – Unë bëra një ndërhyrje në momentin e parë, ndoshta ishte i parakohshëm...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mos duhet saktësuar tani?

**Ermonela Felaj** – Po, mund ta saktësoni.

**Ëngjëll Hysi** – Për shembull, kur themi: “arrest shtëpie”, duhet shtuar “arrest shtëpie me mbikëqyrje elektronike, apo detyrim paraqitjeje, apo të dënuar me dënime alternative”.

Ne sot kemi 8200 vetë me dënime alternative. Një ndër problemet e mëdha që kemi është pamundësia për të njoftuar për shkak të adresave të gabuara, sepse ata mund të kenë ndërruar banesën. I shkojnë në shtëpi dhe u thonë “shko thuaj që nuk e gjeje”. Kjo na krijon një problem shumë të madh për njoftimin e të dënuarve. Mendoj që te rreshti i dytë të themi: “arrest në shtëpi, arrest në shtëpi me mbikëqyrje elektronike, detyrim paraqitje apo të dënuar me dënime alternative”.

**Ermonela Felaj** – Atëherë, detyrohem unë të bëj një diskutim me ju.

Mbikëqyrja elektronike është mënyrë e ekzekutimit të masës së sigurimit “arrest në shtëpi” dhe jo masë e veçantë sigurimi. Përderisa flasim për ekzekutimin e vendimeve, që përmbajnë dënime për të dënuar që kanë qenë në gjendje të lirë ose jo, atëherë në rastin e dytë do të kemi parasysh masat. Kështu që, nuk më duket me vend që të fusim termin “mbikëqyrje”, sepse nuk është masë e veçantë, por mënyrë si do të ekzekutohet mbikëqyrja. Nga ruajtja me policë do të kalohet në mbikëqyrje elektronike. Unë jam dakord për pjesën e dënimeve alternative, por propozoj, dhe e ftoj komisionin që ta ndjekë këtë pjesë, që të thuhet “për të dënuarin me burgim ose me një nga dënimet alternative të dënimit me burgim”.

Nuk është vetëm arresti në shtëpi dhe detyrimi për paraqitje, por ka edhe disa masa të tjera sigurimi në Kodin e Procedurës Penale, për të cilat del një urdhër ekzekutimi dhe parashikohet mënyra e daljes së tyre. Nga të gjitha këto ndryshon vetëm garancia pasurore, ku prokurori pasi merr konfirmimin që garancia është depozituar në bankë, njofton gjykatën dhe në atë moment gjykata vendos që të pandehurin, që e ka në burg, ta lërë të lirë. Ky është kuptimi i kësaj.

Le të përpiqemi të bëjmë një formulim ose t’i sugjerojmë Komisionit të Ligjeve një formulim që të na i përmbledhë të gjitha këto nevoja dhe të mos lëmë asgjë jashtë. Është shumë e drejtë ajo që ngre drejtori i Shërbimit të Provës, ne kemi dënime me burgim, por kemi edhe alternativa të dënimit me burgim, si gjysmë lirie ose vënia në kusht, të cilat është e nevojshme t’i përmbledhim këtu.

**Vasilika Hysi** – Në fakt, unë kam një shqetësim për sa i përket mbikëqyrjes elektronike, sepse kur ka arrest në shtëpi, kompetent është organi i prokurorisë. Zoti Ndreu e di mirë, Paulini e di më mirë. Kur është në arrest në shtëpi me byzylyk, atëherë hyn në lojë Shërbimi i Provës, i cili do të instalojë byzylykun dhe gjithë pajisjen për mbikëqyrjen elektronike. Janë dy institucione që kanë kompetenca në rastet e arrestit në shtëpi kur është me byzylyk ose pa byzylyk elektronik. Nuk merret Policia e Shtetit në rastin e mbikëqyrjes elektronike, por Shërbimi i Provës në bazë të ...

**Ermonela Felaj** – Zoti Hysi, në momentin që gjykata vendos që personi duhet të qëndrojë në arrest shtëpie me mbikëqyrje elektronike, si veprohet për ekzekutimin e kësaj mase në këtë mënyrë? Kush investohet praktikisht? Si keni vepruar deri tani?

**Engjell Hysi** – Zonja kryetare, ka një problem.

Në Kodin e Procedurës është parashikuar vetëm arresti në shtëpi. Termi “arrest në shtëpi me mbikëqyrje elektronike” nuk u pranua kur ne sugjeruam të shtohet si term. Këtu bëhet fjala për njoftimin e personit. Neve na vjen njoftimi që iks shtetasi t’i hiqet byzylyku,

ndërkohë ai mund të ketë kaluar me një masë tjetër. Detyrimi ynë është që vjen firma që ka bërë kontratën, i shkëput byzylykun dhe këtu mbarojnë detyrimet tona.

**Ermonela Felaj** – Pak më herët kush ndërhyt? Ai është në gjykatë ku dhe jepet masa e sigurimit që nga paraburgimi do të shkojë në shtëpi. Kush e bën ekzekutimin e urdhrin? Më pas do t'i vendoset byzylyku. Në këtë moment kush ndërhyt? Ndërhyt policia?

**Ëngjëll Hysi** - Ky është problemi. Ne nuk kemi kompetencë ta marrim në paraburgim, sepse nuk kemi mjete, forca dhe njerëz të armatosur. Kush do ta shoqërojë nga paraburgimi në shtëpi që të vendoset mbikëqyrja elektronike?

**Ermonela Felaj** – Do bëj një propozim dhe më pas do t'ia jap fjalën zotit Ndreu.

Unë e gjej me vend shqetësimin tuaj, sepse vjen nga praktika e punës dhe ka vakuum ligjor për arsye se nuk parashikohet kush do të bëjë njërin dhe kush do të bëjë tjetrin. Mendoj që mund ta zgjidhim duke e shtuar si paragraf më vete. Të mos e quajmë si masë sigurimi të veçantë, sepse nuk e kemi dhe flasim për një ligj të cilësuar që nuk e përmban, por të vendosim një paragraf të veçantë dhe të themi që, për rastet kur është vendosur nga gjykata masa e arrestit në shtëpi me mbikëqyrje elektronike, zhvendosjen e personit nën hetim nga paraburgimi në shtëpi ta bëjë Policia e Rendit, kurse zbatimin e mbikëqyrjes elektronike duhet ta bëjë Shërbimi i Provës.

**Pjerin Ndreu** – Unë kam një pyetje për sa i përket pjesës së ekzekutimit. Sapo të dalë vendimi i gjykatës, që përcakton masën e sigurisë arrest në shtëpi, gjykata shprehet për arrest në shtëpi me mbikëqyrje elektronike. Ku bazohet për këtë gjë??

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po nëse gjykata nuk shprehet çfarë ndodh?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Shprehet për të gjitha rastet e arrestit në shtëpi apo ka raste kur nuk shprehet?

**Ëngjëll Hysi** - Shprehet në mënyrë taksative: “arrest shtëpie me mbikëqyrje elektronike”, por ne nuk e zbatojmë pa na ardhur urdhrin i ekzekutimit të prokurorit. Në momentin kur vjen urdhri i ekzekutimit ne njoftojmë firmën dhe brenda 24 orëve vendosim pajisjen.

**Pjerin Ndreu** – Ka raste kur gjykata nuk e shpreh fare mbikëqyrjen elektronike ...

**Ëngjëll Hysi** - Patjetër.

**Pjerin Ndreu** – Hyn në rol prokurori me urdhrin e ekzekutimit dhe pastaj vijnë Shërbimi i Provës ose Policia e Shtetit. Me sa shikoj unë, kjo pikë nuk ka lidhje fare me Shërbimin e Provës, por i përket Policisë së Shtetit.

**Ermonela Felaj** – Nëse do të fusim dënimet alternative ...

**Pjerin Ndreu** – Përderisa gjykata shprehet, duhet cilësuar mbikëqyrja elektronike.

**Ëngjëll Hysi** - Neni përkatës ka ekzekutimin vullnetar. Në përgjithësi ndodh edhe ekzekutimi vullnetar, por ka mjaft raste kur personi nuk vjen dhe këtu nevojitet ekzekutimi i detyruar me ndërhyrjen e Policisë së Shtetit. Pasi ka mbaruar pjesa vullnetare dhe personi nuk është paraqitur, menjëherë njoftohet Policia e Shtetit, e cila vihet në veprim. Edhe për policinë është barrë shumë e madhe, sepse vetëm ne kemi 8000, pa llogaritur burgjet dhe paraburgimet. Por puna është se në rast se nuk ekzekutohet vendimi, kot që e japim vendimin.

Ajo që unë propozova, është për rastin kur na lind në praktikë kjo, se policia mund të thotë nesër: unë nuk e kam arrest në shtëpi me mbikëqyrje, por kam vetëm arrest në shtëpi.

Po ju sjell një rast, zonja prokurore. Gjukata e shkallës së parë kishte dhënë vendimin për arrest në shtëpi me mbikëqyrje elektronike, të cilin e apeloj prokurori dhe të dy shtetasit vajtën në Gjykatën e Apelit. Megjithatë ne njoftuam policinë dhe prokurorinë, ata nuk u shoqëruan. Gjukata e Apelit e ndryshoi vendimin nga arrest në shtëpi, në arrest me burg dhe u tha të paraqiteshin në gjykatë. Ata dolën të nesërmen dhe ikën në shtëpi dhe me sa di unë, nuk janë kapur as sot që flasim. Prandaj, është e detyrueshme prania e policisë në këto raste. Megjithatë, ta diskutojmë.

**Ermonela Felaj** – Mendoj se duhet të bëj një përmbledhje të të gjitha propozimeve. Nuk e di, nëse kishit edhe ju një ndërhyrje, Paulin?

**Paulin Sterkaj** – Më tepër e kam në formë diskutimi, meqenëse po rrotullohem. Që ta bëjmë pikë për pikë të zbatueshme këtë, duhen 5-6 nene të tjera.

E dyta, ne, si shqiptarë, akoma nuk jemi mësuar që dënimi alternativ është vullnetar. Pra, ne duam ta shoqërojmë dënimin alternativ me polici, me prokurorë, me gjykata, por kjo ka kosto shumë të madhe. Atëherë, personat duhet të jenë vullnetarë për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Besoj se Kodi Penal i parashikon masat që merren kur shkelet arresti në shtëpi, kështu që nuk kemi pse të merremi dhe të futemi në këtë marrëdhënie. Edhe ne duhet të edukohemi që nuk duhet të kemi gjithçka dhe gjithkush çdo gjë në dorë, kur parashikohet dënimi alternativ. Meqë ne duam të shkojmë në Europë, a ka mundësi të marrim një eksperiencë nga shtetet e zhvilluara të Europës se si funksionojnë këto dënime? Pse duhet të prodhojmë ne ligje të reja dhe forma e mënyra të tjera, kur ne duam të aderojmë në Europë, e cila ka eksperiencën të mjaftueshme për të parë se si janë këto fenomene në

Europë? Pse duhet të bëjmë gjëra të veçanta si gjithmonë, kur ne nuk na pëlqen, sajojmë një projektligj dhe në fund të fundit nuk dalim aty ku duhet? Kjo ishte si ide.

Me diskutimet e deritanishme, ne duhet të bëjmë edhe 5-6 nene të tjera për ta bërë të zbatueshme këtë dhe ndoshta, biem ndesh edhe me orientimet...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Urdhëroni?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ndoshta mund të gjejmë forma, por deri tani, kështu siç është ky nen, është i ngatërruar dhe nuk e zgjidh situatën.

**Ermonela Felaj** – Jo, është e qartë se ai nuk e zgjidh të gjithë situatën, që shtrohet në praktikë.

Urdhëroni, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë e mirëkuptoj shqetësimin e kolegut, por këtu kemi nenin 24, që flet për njoftimin për ekzekutim vullnetar dhe me këtë projektligj nuk është prekur paragrafi i parë, i cili rregullon shqetësimin që ngriti kolegu Sterkaj (që ekzekutimi është vullnetar dhe personat paraqiten vetë). Këtu i është shtuar një paragraf i dytë paragrafit ekzistues të ligjit, që flet se çfarë ndodh nëse ai nuk paraqitet vetë. Në këtë rast (me të drejtë sot shumica e njerëzve që dënohen me dënime alternative, nuk shkojnë vetë), do të vijë dhe do të hyjë në lojë Policia e Shtetit, sepse është një dënim penal alternativ. Pra, nuk është lënë e lirë. Ai është dënuar për një krim të rëndë, apo për drogë dhe është në shërbim prove. Pra, ne nuk kemi në shërbim prove thjesht njerëz që kryejnë vepra penale të rrezikshmërisë të ulët, por ka njerëz për të cilët Kodi Penal parashikon 5-7 vjet burg. Pra, një faki-fukara mund të rrijë në burg dhe një tjetër të jetë në shërbim prove. Prandaj duhet bërë njoftimi me polici dhe ai nuk duhet të vijë ditën e fundit kur mbaron dënimi, por duhet të vijë dhe ta vuajë dënimin me të gjitha detyrimet një për një, sepse në të kundërt, kjo është aferë korruptive dhe nuk ka kuptim dënimi, kot që i japim dënime alternative pastaj.

**Ermonela Felaj** – Urdhëroni, zoti Qefalia!

**Xhemal Qefalia** - Doja të thosha atë që tha zonja Hysi. Për sa kohë kemi një vendim për një dënim penal, ai duhet respektuar. Po të kemi parasysh ndryshimet që i janë bërë Kodit Penal për të miturit, ku një masë dënimi që konvertohet deri në 7 vjet vuajtje dënimi me burg, kalohet me dënim alternativ, ajo është një masë, e cila duhet kontrolluar.

**Ermonela Felaj** – Është e qartë se pjesa penale është e zgjidhur në Kodin Penal për dikë që nuk i zbaton detyrimet, që rrjedhin nga një vendim penal ose nga një vendim civil. Është një nen, i cili shoh se është ndryshuar edhe në vitin 2000, neni 320/a i Kodit Penal. Megjithatë, që të mos mbetemi te Kodi Penal se nuk po diskutojmë për të, unë po mundohem të bëj një përmbledhje.

**Vasilika Hysi** – Ju kërkoj ndjesë, se kam një relativitet në Komisionin e Ligjeve!

A mund të largohem?

**Ermonela Felaj** – Dakord.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Është e njëjta gjë. Megjithatë, unë po vazhdoj me kolegët, duke bërë një përmbledhje të atyre që u thanë deri tani.

Propozimet që u shtruan dhe që natyrisht, duhen reflektuar në këtë nen, janë:

E para, përveç mënyrës së detyruar të ekzekutimit të dënimeve me burgim, duhet parashikuar edhe mënyra e ekzekutimit të dënimeve alternative me burgim, që janë 3: gjysmë liria, qëndrimi në shtëpi, vënia në kusht.

E dyta, duhet parashikuar se si do të zbatohet masa e sigurimit arrest në shtëpi me mbikëqyrje elektronike.

Propozimi tjetër ishte për rastin kur njoftimi nuk realizohet dhe duhet t'u drejtohem organeve vendore dhe unë jam dakord me propozimin e zotit Braho, që kjo është shumë e gjerë dhe natyrisht, duhet të dimë organin konkret, të cilit duhet t'i drejtohem. Për praktikë të punës, besoj se edhe këtu e gjetëm gjuhën e përbashkët, që ky organ të ishte inspektori i zonës ose specialisti i zonës, të cilët njihen, sepse normalisht ata i kanë kontaktet dhe të gjitha. Besoj se me këtë mënyrë, me këto propozime ne i reflektojmë të gjitha shqetësimet tuaja, apo jo zoti Hysi? A jemi dakord? A kemi lënë diçka pa përmendur?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk po hyjmë te njoftimi konkret, sepse për formulimin konkret para se të kalojmë në miratimin në tërësi, do të përgatisim një draft, sipas këtyre propozimeve dhe atëherë do ta kalojmë. Sot do ta kishim pothuajse të pamundur ta bënim këtë gjë, por propozimi ishte që të reflektohen në nenin 1, të gjitha ato që unë përmenda pak më parë, pa dashur t'i përsëris.

Jemi dakord që të reflektohen të gjitha këto propozime?

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Faleminderit!

Kalojmë te neni 2 i projektit, që ndryshon nenin 31/4 nënparagrafin e dytë. “Shërbimi i Provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit me qëndrim në shtëpi në mënyrë të vazhdueshme deri në përfundimin e periudhës së mbikëqyrjes në vendin ku i dënuari është duke e vuajtur dënimin alternativ dhe bashkëpunon sipas rastit me autoritetin e pushtetit vendor, shërbimet sociale, organet vendore të policisë dhe subjektet e tjera private dhe shtetërore.”

Këtu u ngrit një propozim pak më parë dhe u tha se çfarë ndodh në rastin kur i dënuari ndryshon vendbanimin. U propozua që të shtohet një paragraf i dytë. Nëse kolegët kanë nevojë ta ridëgjojnë, se përse bëhet ky propozim, ia jap fjalën zotit Hysi.

**Ëngjell Hysi** – Atëherë, në praktikë kemi pasur raste që i dënuari me arrest shtëpie, ka pasur arsye të ligjshme dhe objektive për të ndërruar banesën, por ne e kemi pasur të pamundur të gjejmë një zgjidhje me prokurorinë dhe gjykatën, sepse nuk ka një rregullim ligjor. Propozimi im është për shtimin e një paragrafi, ku të bëhet rregullimi ligjor i rasteve kur personi i dënuar kërkon të ndërrojë banesën. Të gjithë e gjejmë me vend që personi duhet ta ndërrojë banesën. Për shembull, personi nuk është vetë i sëmurë, por ka gruan dhe do që të jetë sa më pranë saj, pra ka arsye objektive dhe të ligjshme që ta ndërrojë banesën. Prandaj duhet të ketë një paragraf që e lejon ndryshimin e vendbanimit me vendim gjyqate, sepse gjykata është ajo që vendos vendin se ku do ta vuajë dënimin dhe ajo duhet të japë vendimin për vendin e ri ku duhet ta vazhdojë dënimin.

**Ermonela Felaj** – Të nderuar kolegë, ky është propozimi i zotit Hysi. A jeni dakord propozimi i tij të shtohet në këtë paragraf?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord. Do ta riformulojmë që kjo shtesë të reflektohet.

Kalojmë në nenin 3. Ky nen ndryshon paragrafin 6 të nenit 31 të ligjit ekzistues “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Nga diskutimet që u bënë, kishte një pyetje nga zoti Braho, a duhet të parashikojmë penalitete në ligj në momentin kur personi i liruar me kusht ka ndryshuar vendbanimin dhe nuk ka bërë njoftimin te shërbimi i provës? Pra, një person që lirohet para kohe nga vuajtja e dënimit me burgim, ka disa kushte që duhet t’i zbatojë, për shembull, të mos i afrohet x lokaleve ose të mos frekuentojë persona të caktuar. Në momentin kur personi ndryshon vendbanimin dhe nuk e ka bërë njoftimin paraprakisht, a duhet të parashikojmë një penaltet që ta mbyllim këtë situatë?

Fjalën e ka zoti Hysi.

**Ëngjëll Hysi** – Në praktikë ne kemi pasur raste të ndryshimit të vendbanimit, gjithmonë ata janë drejtuar te Shërbimi i Provës me një kërkesë dhe ne kemi miratuar lëvizjen, për shembull, nga Gjirokastra në Tiranë dhe automatikisht kemi njoftuar policinë dhe prokurorinë e Gjirokastrës dhe të Tiranës. Por ne kemi gjetur një zgjidhje, sepse në momentin që ai do të transferohet me banim në Tiranë, mbikëqyrjen e tij e merr zyra e Tiranës. Pra, qytetari lëviz, por jo shërbimi, sepse ne kemi shërbim në Gjirokastrë dhe në Tiranë. Nuk ka asnjë arsye, kur një qytetar ndërron banesën, të mos informojë, sepse ne ia kemi dhënë si alternativë që duhet të informojë. A duhet parashikuar ndonjë klauzolë ndëshkimore nëse ai nuk njofton? Nëse duhet, unë jam dakord.

**Ermonela Felaj** – Pra, ju po thoni që deri tani nuk ka ndodhur që një person i liruar me parakusht të mos informojë për vendbanimin?

**Ëngjëll Hysi**– Jo nuk ka ndodhur. Ne ua themi që, nëse doni të ndërroni banesën, duhet të komunikoni me ne dhe të shpjegoni edhe arsyet. Por e drejta e lëvizjes së lirë të qytetarit nuk pengohet në këtë rast.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në momentin që një person dëshiron të ndërrojë banesën për një arsye si shkolla, puna e të tjera, ai na njofton dhe ne njoftojmë policinë dhe prokurorinë e atij vendi ku shkon personi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ermonela Felaj** – Ai nuk mund ta bëjë ashtu, sepse mund të ketë detyrimin të mos dalë jashtë shtetit gjatë kohës së dhënies së provës dhe, nëse ai e thyen këtë, ai thyen vendimin dhe ka një vepër penale.

**Ëngjëll Hysi**– Ju e ngritët si problem, por sot në ligj qytetari nuk e ka të ndaluar që të dalë jashtë shteti.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për qytetarin me dënim alternativ nuk kemi asnjë ligj që e pengon atë të dalë jashtë shteti.

**Ermonela Felaj** – Dakord, mund të mos ketë, por parimisht gjykata ka dhënë vendimin dhe të ka thënë: ti ke plotësuar kushtet, ke bërë qaq pjesë të dënimit me burgim dhe të takon të lirohesh para kohe, por ke edhe 5 detyrime që duhet t'i zbatosh. Në momentin që këto detyrime thyen, atëherë kryhet një vepër penale, sepse është thyer vendimi i gjykatës. Këtu besoj se zgjidhet edhe pyetja e zotit Braho, edhe kur nuk ju njofton ai.

**Ëngjëll Hysi** – Gjykatat, kur japin vendimin, i referohen edhe nenit 60 të Kodit Penal, ku janë detyrimet shtesë si, për shembull, të mos shoqërohet, të mos frekuentojë këtë, të mos largohet nga njësia administrative e të tjera. Nëse gjykata ka vendosur që nuk ka të drejtë të ndryshojë njësinë administrative, ne nuk ia japim këtë të drejtë, pra vendimi i gjykatës shoqërohet edhe me nenin 60.

**Ermonela Felaj** – Besoj se e kemi të zgjidhur këtë çështje me sqarimet që ju dhatë.

**Ëngjëll Hysi** – Për mua është në rregull.

**Ermonela Felaj** – Kush është dakord me nenin 3 të projektligjit, kështu siç është propozuar? Dakord janë kolegët.

Faleminderit!

Kalojmë ne nenin 4. Ky nen ndryshon paragrafin 9 të nenit 31 të ligjit “Për ekzekutimet e vendimeve penale”. Pra, bëhet fjalë për nenin që titullohet “Ekzekutimi i dënimit alternativ”.

Këtu pati një sugjerim të drejtë nga zoti Hysi, sepse nga mënyra sesi shkruhet një ligj nuk mund ta lësh “ose ky, ose ai”, këtu thuhet: “I kërkohet gjykatës ose prokurorit”, pra iniciuesi i projektit, mesa duket, ka qenë në dilemë se kujt duhet t’ia lërë këtë detyrim. Është momenti kur i dënuari ka filluar vuajtjen e dënimit alternativ më vonë se sa koha kur vendimi ka marrë formë të prerë. Shërbimi i Provës njofton prokurorin, i cili i kërkon gjykatës të përcaktojë si datë të fillimit të afatit të mbikëqyrjes datën kur i dënuari ka vendosur kontaktin e parë me Shërbimin e Provës. Pra, do të mbajmë marrëdhënien Shërbim Prove dhe prokuror, apo do të mbajmë marrëdhënien Shërbim Prove, prokuror dhe gjykatë dhe kthehemi mbrapsht pastaj?

Fjalën e ka zoti Hysi dhe pastaj zoti relator.

**Xhemal Qefalia**– Për të sqaruar kolegët, bëhet fjalë për një të dënuar, i cili po vazhdon ta ekzekutojë vendimin, është duke e kryer në shtëpi, ndërkohë që Shërbimi i Provës nuk ka dijeni dhe, kur shkon shkresa te Shërbimi i Provës, mund të ketë kaluar një muaj që ai është duke e vuajtur. Problemi është që personi është i pamonitoruar nga Shërbimi i Provës, apo jo zoti Hysi?

**Ëngjëll Hysi** – Ndryshimet që pësoi Kodi Penal vitin e kaluar, konkretisht neni 59 parashikon që për dënimet deri në 2 vjet gjykata jep një masë me burg që konvertohet në dyfishin me shërbim prove. Nga praktika ne kemi raste që gjykata jep 14 ditë burg, e konvertuar me 28 ditë shërbim prove. Procedurat e kalimit të vendimit të gjykatës deri në prokurori dhe deri sa kjo nxjerr urdhrin e ekzekutimit kalon një muaj. Ne kemi raste kur

urdhri i ekzekutimit na vjen ose dy ditë para, ose dy ditë pasi personi ka mbaruar shërbimin e provës. Problemi është a do ta quajmë të kryer këtë dënim apo jo?

**Ermonela Felaj** – Kur, në fakt, ai nuk ka bërë asnjë ditë.

**Engjëll Hysi** - Ne nuk e kemi këtë kompetencë. Ne i drejtohem prokurorit dhe prokurori tani është në dilemë. Unë mendoj se rregullimi është i saktë, pra që ne do t'ia referojmë prokurorit, sepse nuk kemi pse ta shmangim rolin e tij për ekzekutimin e vendimeve penale. Pra, kur i dënuari nuk paraqitet në kohën e caktuar, Shërbimi i Provës i referohet prokurorit, i cili i kërkon gjykatës zgjatje të afatit.

**Ermonela Felaj** – Atëherë, do ta heqim pjesën “ose vetë prokurori”.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Jo, ditën që shkon te Shërbimi i Provës, sepse i dënuari për këtë gjë shkon atje.

**Pjerin Ndreu** – A mund të ndërhyj?

**Ermonela Felaj** – Po, zoti Ndreu.

**Pjerin Ndreu** – Në ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale” nuk mund t'i themi prokurorit t'i kërkojë gjykatës zgjatje të afatit, sepse me ligj unë di se prokurori ndërhyr direkt pas vendimit të gjykatës dhe nxjerr urdhrin e ekzekutimit. Edhe kur ka lirime para kohe me kusht, është prokurori ai që përllogarit ditën e fillimit dhe ditën e mbarimit të dënimit. Pra, prokurori është kompetent. Nëse prokurori ka një problem, që nuk e interpreton dot, atëherë është e drejta e tij që t'i drejtohet gjykatës, ndërsa ju, si institucion, i drejtoheni vetëm prokurorit. Pra, detyra e Shërbimit të Provës mbaron kur i drejtohet prokurorit, më pas se çfarë bën prokurori nuk mund ta cilësojmë ne më një ligj të tillë, sepse kjo vjen për shkak të detyrimeve që merr në Kodin e Procedurës Penale. Pra, është e qartë se prokurori është hallka e ndërmjetme që nxjerr urdhrin e ekzekutimit të vendimit penal dhe bën përllogaritjet e paraburgimit dhe të gjitha llogaritjet e tjera.

**Ermonela Felaj** – Besoj se është e drejtë ndërhyrja e zotit Ndreu, sepse është i drejtë edhe argumenti që prokurori, më tej edhe gjykata nuk i marrin detyrimet drejtpërsëdrejti nga ky ligj, por i marrin nga Kodi i Procedurës Penale.

Së dyti, është prokurori ai që bën llogaritjet dhe data e fillimit të dënimit është llogari në vetvete. Kështu, ndoshta ne duhet ta shkruajmë siç e propozon zoti Ndreu. Pra, ju t'i drejtoheni prokurorisë që të përcaktojë datën e fillimit dhe më pas prokuroria le ta zgjidhë vetë këtë gjë. Unë besoj se ne nuk duhet të futemi në detyrimet e tyre, sepse ata nuk veprojnë thjesht dhe vetëm me bazën e këtij ligji. A biem dakord, sepse të paktën kështu zgjidhim edhe shqetësimin që ju adresoni, që ka të bëjë me ditën e parë kur i dënuari quhet se është në

Shërbimin e Provës? Pra, këtë përgjegjësi ju ia lini prokurorisë dhe më pas prokuroria vepron vetë, si për çdo urdhër ekzekutimi të zakonshëm, ku thotë: “Ka filluar dënimi në këtë datë, ka vuajtur kaq ditë në paraburgim, që konvertohen në kaq ditë burgim, kanë mbetur edhe kaq ditë dhe duhet të dalë në këtë datë”. Më pas këtë urdhër, me të gjitha këto specifika, ia dërgon Drejtorisë së Burgjeve dhe policisë. Kështu që le t’ia lemë prokurorisë dhe më pas prokuroria e zgjidh vetë se si do ta zbatojë praktikisht.

**Ëngjell Hysi** - Dua të bëj një sqarim.

Te neni 59 ka një nonsens juridik, ku thuhet: “Dënimet alternative të nesërmen e vendimit të gjykatës”. Pra, këtu hiqet e drejta e ankimit, hiqet e drejta që vendimi të marrë formën e prerë, si dhe hiqet e drejta e pafajësisë.

Pra, në nenin 59 të Kodit Penal thuhet: “Dënimi alternativ fillon të nesërmen e vendimit të gjykatës”. E nesërmja e vendimit të gjykatës dhe dita kur i dënuari paraqitet te ne, në pjesën më të madhe, nuk është e njëjta ditë. Atëherë kë do të marrim në konsideratë, të nesërmen apo ditën kur i dënuari paraqitet te ne? Kjo është dilema që ne gjithmonë jemi në debat me prokurorinë.

**Ermonela Felaj** – Unë e kam këtu para nenin 59, pika 2, të Kodit Penal, ku thuhet: “Gjykata urdhëron që i dënuari të përmbushë një apo më shumë detyrime, të parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi”. Në nenin 60 janë thjesht detyrimet e dënuarit të vënë në provë.

**Ëngjell Hysi** - Jo është te neni 59.

**Ermonela Felaj** – Nenin 59 lexova.

Ndoshta ne duhet ta verifikojmë këtë gjë për saktësi.

**Ëngjell Hysi** - E ka të saktësuar “të nesërmen..”

**Ermonela Felaj** – Nuk e ka këtë gjë. Kodi Penal nuk ka pse të merret me përllogaritje.

**Ëngjell Hysi** - Jam dakord me ju, zonja kryetare, por për herë të parë Kodi Penal ka futur shprehjen “të nesërmen e vendimit të gjykatës”.

**Ermonela Felaj** –Dakord!

Mendoj se jemi më efektivë nëse i përmbahemi ndërhyrjes së zotit Ndreu, sepse në këtë mënyrë zgjidhim edhe shqetësimin tuaj. Për më tej mund ta shikoni edhe te Komisioni i Ligjeve, në qoftë se nuk ua përmbush nevojën.

Pra, a jemi dakord me ndërhyrjen e zotit Ndreu për ta reflektuar në këtë pjesë? Dakord!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Faleminderit!

Kalojmë në nenin 5 të projektit, i cili ndryshon paragrafin 2, të nenit 34 të ligjit, ku shtohet togfjalëshi “kur nga gjykata nuk është vendosur ndryshe”. Pra : “Dënimet e tjera plotësues ekzekutohen pas vuajtjes së dënimit kryesor, kur nga gjykata nuk është vendosur ndryshe.” A jeni dakord me këtë propozim? Dakord!

Faleminderit!

Kalojmë te neni 6 i projektit, i cili ndryshon paragrafin 2 të nenit 39 të ligjit.

Më herët u bënë dy sugjerime për riformulimin e termit “jashtë territorit”, që besoj se është i drejtë, sepse duhet të kuptojmë që bëhet fjalë për jashtë vendit dhe ndoshta termi “jashtë territorit” mund të zëvendësohet me termin “dorëzime jashtë vendit”. Gjithashtu, nga Elona kemi një propozim për emërtimin e Drejtorisë së Migracionit.

Po, zoti Paulin.

**Paulin Sterkaj** – Kam edhe unë diçka. Nëse themi “jashtë territorit”, duhet të kemi parasysh se një të dënuar nuk e pranon asnjë shtet komshi yni, sepse personi i dënuar mund të jetë nga Portugalia, por e vuan dënimin në Shqipëri. Nëse ne themi: “jashtë territorit” dhe këtë të dënuar e çojmë në Mal të Zi apo në Itali, atëherë cili nga këto shtete e pranon? Kështu që ne duhet të theksojmë shprehjen: “të riatdhesohet”, sepse ky person është shtetas i huaj. A po flasim për shtetasit e huaj, apo jo?

Pra, nuk bëhet fjalë që ne po nxjerrim shqiptarët jashtë territorit të Shqipërisë, por bëhet fjalë për një shtetas të huaj. Atëherë, këtë shtetas të huaj duhet ta riatdhesojmë që ta çojmë drejt vendit të tij, sepse nuk ta pranon asnjë shtet tjetër që, edhe se ka vajtuar dënimin në Shqipëri, të qëndrojë përkohësisht në Itali. Unë kështu e mendoj.

**Ermonela Felaj** – Zoti Semani, dua mendimin tuaj lidhur me ndërhyrjen e zoti Sterkaj, për ta sqaruar edhe një herë situatën në të cilën bëhet fjalë.

**Erion Semani** - E nderuar zonja kryetare, këto janë raste kur vendoset për depërtimin e shtetasve të huaj jashtë territorit të vendit. Sugjerimi i deputetit faktikisht është me vend, sepse bëhet fjalë për jashtë territorit të vendit. Në fund këtu kemi: “...sa të plotësohen kushtet për largimin e tij nga territori.” Pra, kemi depërtimin e të dënuarve nga territori ynë.

**Ermonela Felaj** - Zoti Semani, duhet të kemi parasysh se neni aktual titullohet: “Nxjerrja jashtë territorit” dhe ka që nga viti 1998 dhe deri tani që zbatohet kështu. A ka krijuar probleme termi? Me sa duket jo, sepse ka kaq vjet që zbatohet në këtë mënyrë. Tani ne për korrektesë do t’u qëndrojmë termave që ligji përdor aktualisht.

**Erion Semani** - Ndonjë problematikë të specifikuar nuk ka.

**Ermonela Felaj** - Nuk besoj se kanë qenë problem fjalët “jashtë territorit” që të vihet me këtë propozim. Unë mendoj se problemi ka qenë se me kë bashkëpunoni ju dhe me kë e bëni dorëzimin e personit. Ndërhyrja është thjeshtë për Drejtorinë e Migracionit.

**Erion Semani** – Ndërhyrja është shumë me vend, pasi gjithmonë Drejtoria e Policisë së Burgjeve do orientim. Në rastin konkret, është me vend Drejtoria e Migracionit, por duhet bërë thjesht saktësimi i territorit të vendit.

**Paulin Sterkaj** – Po ju jap një shembull: kur punonim në polici, ka pasur raste që kanë ardhur emigrantë të paligjshëm në Shqipëri. Ne kemi tentuar për t’i deportuar në shtetet fqinje, por ato nuk i kanë pranuar. Atëherë, janë rikthyer dhe riatdhesuar këtu.

Termi “jashtë territorit” mund të jetë term që funksionon, por duhet të theksohet “drejt atdheut të tij”, se dakord, e nxjerr jashtë Shqipërisë, në Mal të Zi, Maqedoni, Kosovë apo Itali, por a ta pranojnë?!

**Ermonela Felaj** - Edhe një herë, situata është e tillë, deri tani, se nuk ka ndonjë ndryshim të madh, e vetmja gjë që është shtuar, e cila e ndryshon këtë nen, është fakti që Policia e Burgjeve kërkon që në një moment të tillë të mos veprojë e vetme, por të ketë edhe mbështetjen e Drejtorisë së Migracionit.

Dua t’ju bëj një pyetje në mënyrë që të zgjidhim shqetësimin e të gjithëve: pse ju duhet mbështetja e Drejtorisë së Migracionit? Çfarë ka ndodhur në praktikë që jua ka bërë jetën të vështirë juve të Policisë së Burgjeve?

**Erion Semani** – Siç përmenda rastet e ekstradimit, të cila janë të përcaktuara në gjykatë, del urdhri i ekzekutimit, është Zyra e Interpolit, dhe që në rastin konkret përmendet që ky shtetas do të dalë jashtë territorit të Shqipërisë në mënyrë tokësore, Policia e Burgjeve bën shoqërimin, por nuk është ajo që vendos, ndaj do të duhej të kishte një bashkëpunim. Edhe për rastet e deportimit kërkohej bashkëpunimi me Drejtorinë e Migracionin. Policia e Burgjeve mund të bëjë vetëm shoqërimin, orientimin e jep Drejtoria e Migracionit sipas vendimit të gjykatës.

**Ermonela Felaj** - Nuk e mora të plotë përgjigjen.

Deri më sot nuk e keni pasur të shprehur në ligj që duhet t’u bashkohet edhe Drejtoria e Migracionit. Çfarë problemi ju ka ndodhur? Dakord, do ta shtojmë edhe këtë drejtori, por çfarë roli do të ketë ajo? Nuk duhet të jetë kot për figurë aty!

**Erion Semani** – Do të ishte më efektive të bëhej ky bashkim për dinamikën që ka për shoqërimet, pasi ata gjithmonë bëjnë shoqërimet për rastet në gjykatë apo shoqërojnë për

efekt ekstradimi. Kuptohet që është në zbatim të vendimit të gjykatës, por ky bashkëpunim është shumë i domosdoshëm për bashkërendimin e punës.

**Ermonela Felaj** - Pra, ju po thoni që deri tani nuk keni vepruar vetëm, por në bashkëpunim me ta dhe do të donit që kjo të shkruhej edhe në ligj?

**Erion Semani** – Po, ne mendojmë se është e domosdoshme.

**Ermonela Felaj** - Nga fjalët tuaja del që deri tani nuk keni vepruar vetëm, se është futur edhe Drejtoria e Policisë në lojë...

**Engjëll Hysi** – Drejtoria e Migracionit, në termin e vjetër, “Policia Kufitare” hyn në lojë në rastet kur po e nxjerr jashtë shtetit me avion etj. etj. Ky është një detyrim që nuk ka nevojë për t’u përcaktuar edhe në ligj, pasi vjen natyrshëm për shkak të natyrës së shërbimit që ka vetë Policia Kufitare. Në qoftë se ti e shoqëron dhe e çon deri atje, ai tashmë nuk është më në gjendje arresti, por bëhet fjalë për dënime alternative, pra kur është i liruar me kusht.

Unë nuk e kuptoj pse duhet ta vëmë me detyrim, kur, në fakt, në detyrat e saj funksionale nuk konvergon që të marrë detyrime se vjen një iks për ta shoqëruar, mbikëqyrur etj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është shërbim që e jep për këdo, edhe për personat që janë të arrestuar, edhe për ata që vijnë si të deportuar, pra i ka të përcaktuara masat e veta dhe nuk është e nevojshme futja në ligjin për ekzekutimin e veprave penale. Ka detyrat e veta funksionale dhe vihet në funksion për shkak të tyre.

Pra, kjo, për mendimin tim, është një mbivendosje ligji, kot së koti. Kështu që ti, çoje atje, jepi statusin e personit çfarë ka, dhe ai e di. Edhe kur vijnë, ai ose është i depërtuar, ose i arrestuar, ose në kërkim, dhe shërbimi merr masat, sepse këtë e ka detyrë funksionale. Nuk është e detyrueshme ta vendosim në ligj.

**Ermonela Felaj** - Fjala për zotin Paulin.

**Paulin Sterkaj** – Shqetësimi i drejtorit të Drejtorisë së Burgjeve është real. Ne nuk po gjejmë atë që duhet të gjejmë, sepse, kur i burgosuri mbaron dënimin...

**Ermonela Felaj** - Bëhet fjalë për të burgosur të huaj?

**Paulin Sterkaj** – Po, për të huajt. Kur i burgosuri mbaron dënimin, si rregull, Policia e Burgjeve e përcjell deri te dera e burgut dhe më pas, personin duhet ta marrë institucioni tjetër që monitoron qëndrimin e të huajve në Shqipëri, Drejtoria e Migracionit, në këtë rast. Prandaj kjo gjë duhet parashikuar në ligj dhe të mos e spetojmë sa andej-këndej për të dalë dikush më i zoti e dikush më i mençur. Ky është shqetësimi i tyre.

Drejtoria e Migracionit e ka të përcaktuar detyrimin sesi mund të jetojë një shtetas i huaj dhe Shqipëria, ka një ligj kuadër, por, meqenëse ai del nga institucioni i dënimit, duhet të informohet dhe të drejtohet për të ikur nga vendi. Ai mundet të kërkojë edhe azil politik kur del nga burgu...

**Ermonela Felaj** - Do të doja të dëgjoja edhe zonjën Gjebrea.

**Elona Gjebrea** – Faktikisht është siç thotë zoti Paulin, por unë mendoj se duhet përcaktuar për vetë faktin që është shqetësim.

Pra, në qoftë se themi që ekzekutohet nga Policia e Burgjeve, sipas legjislacionit në fuqi për të huajt, aty futen në lojë të gjitha strukturat që merren me këtë gjë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A po themi se është shqetësim?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ermonela Felaj** - Kanë ndodhur raste kur shërbimet e kanë lejuar dikë të largohet, ndërkohë nuk janë marrë vesh me policinë që ai person ka një detyrim, apo dënim...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Këto janë situata që kanë ndodhur...

**Paulin Sterkaj** – Në qoftë se ka ndodhur siç mund të ndodhë me Policinë e Rendit, por kjo nuk do të thotë që...

Me detyrat funksionale në momentin që shkon te shërbimet e Policisë Kufitare, është e detyruar menjëherë të marrë masat. E ka ligjërisht të shkruar...

**Ermonela Felaj** – Atëherë, do të bëj një përmbledhje të dy qëndrimeve të mbajtura këtu: situata është e tillë, bëhet fjalë për shtetas të huaj që kryejnë vepra penale që dënohen në Shqipëri ose për persona që janë shqiptarë, por e kanë lënë shtetësinë shqiptare, sepse kanë një nënshtetësi të huaj dhe duhet të kthehen në vendin e tyre. Atëherë, pasi mbarojnë dënimin me burgim, do të dalin nga burgu, natyrisht do të dalin jashtë vendit, sepse ka disa rregulla si për gjithë qytetarët e lirë, për të lëvizur jashtë vendit. Në këtë moment mua më bën sens që duhet të futen në lojë edhe shërbimet e migracionit, që të sigurojnë që ai vërtet të dalë nga vendi, sepse interesi nuk është ta mbajmë këtu, interesi është ta nxjerrim dhe të sigurohemi që kjo u krye. Domethënë, është ky qëndrim, besoj se kështu e kuptova atë që thotë zoti Ndreu, është edhe qëndrimi juaj, që thoni se këto detyrime nuk kanë nevojë të shkojnë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po e them, ashtu siç e kuptova nga ty dhe nga Elona, që shërbimi e ka për detyrë dhe duhet të futet dhe ndoshta kjo nuk duhet shkruar në ligj. Pra, ta shkruajmë në ligj apo mos ta shkruajmë në ligj, për këtë duhet të marrim një vendim.

**Pjerin Ndreu** – Në qoftë se ne do ta vendosim, sepse kështu është në Shqipëri, duhet t’ua themi, në 5 ligje përnjëherë, të njëjtën gjë bëjnë tek të gjitha. E ka detyrë funksionale, megjithatë duhet të heqim fjalën “bashkëpunim”. Atëherë, nëse i thonë nuk ka bashkëpunim, ka detyrim, në ligj do të marrë detyrimin. Thuhet: “Kur i dënuari ka pasur dënimin kryesor burgimin, nxjerrja jashtë territorit ekzekutohet nga Policia e Burgjeve dhe nga Drejtoria e Migracionit”, pra nuk ka bashkëpunim. Nëse vendosim termin “bashkëpunim” e lë evaziv, bashkëpunon, nuk bashkëpunon.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Atëherë, në qoftë se doni, vendoseni dispozitë detyruese dhe shtrëngoja rripin, sepse e ke për detyrë zotëri. Detyra i vjen automatikisht nga detyra funksionale që kryen aty realisht dhe ne nuk kemi nevojë, por, meqenëse duhet ta bëjmë, t’ia bëjmë detyruese, jo në bashkëpunim.

**Ermonela Felaj** - Besoj se është shumë konstruktive ndërhyrja e zotit Ndreu, sepse na i zgjidh të gjitha ato që patëm. Kështu që, me ndërhyrjen e fundit të zotit Ndreu, besoj se biem dakord që ta miratojmë këtë propozim, duke vendosur detyrimin e përbashkët, të Drejtorisë së Policisë së Burgjeve dhe të Drejtorisë Migracionit, për nxjerrjen jashtë territorit personat e dënuar me burgim në Shqipëri.

Kalojmë te neni 7, i cili ndryshon nenin 46 të ligjit, konkretisht është parashikuar që të ndryshojë paragrafi i dytë i këtij neni, ku thuhet: “Kur nuk bëhet ekzekutim vullnetar në datën e caktuar, (është fjala për masat edukuese) të miturit që çohen në institucione riedukimi, ekzekutimi bëhet nga Policia e Shtetit, e cila merr masat përkatëse për ekzekutimin e vendimit, duke e shoqëruar personin me masa edukuese me një punonjës social ose psikolog gjatë gjithë kohës që e shoqëron atë për në institucionin përkatës”. Në fakt, më shumë dua të dëgjoj kolegët që vijnë nga eksperiencia policore, nëse jemi dakord me këtë, sepse ka të bëjë me një detyrim të Policisë së Shtetit.

Urdhëroni, zoti Ndreu!

**Pjerin Ndreu** – Jam dakord.

**Ermonela Felaj** - Kush është dakord me nenin 7? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

**Erion Semani** – Kodi i Drejtësisë për të Mitur ka futur termin “shmangie” dhe neni 46, pikërisht, bën fjalë për shmangien. Kam një sugjerim, që ta shikojmë në raport edhe me Kodin e Drejtësisë për të Mitur. Nuk e di, ekipi që ka punuar e ka pasur në konsideratë, sepse këtu është edhe shoqërimi në një vend të caktuar edukimi, që praktikisht nuk është hapur ende, ndërsa këtu vihet detyrimi kur ai nuk ekzekuton vullnetarisht shoqërohet nga policia këtu është shtuar termi “me psikolog ose punonjës social”. Duhet ta shikojnë në raport me Kodin e Drejtësisë për të Miturin, se ndoshta ka ndonjë parashikim tjetër dhe na përplasen të dyja ligjet. E kam thjesht për sugjerim.

**Ermonela Felaj** - Dakord me ndërhyrjen tuaj.

Përpara se ta miratojmë në tërësi projektligjin, do ta verifikojmë edhe këtë moment.

Kalojmë në nenin 8 “Hyrja në fuqi”.

Kush është dakord me hyrjen në fuqi të këtij ligji, me afatin e zakonshëm? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Falënderoj kolegët dhe të ftuarit për prezencën!

Miratimin në tërësi të këtij projektligji do ta bëjmë në mbledhjen e ardhshme, pasi të kemi riformuluar të gjitha sugjerimet që u dhanë gjatë kësaj mbledhjeje.

U lutem kolegëve të komisionit vetëm një minutë për dy njoftim. Ditën e nesërme në orën 10:00 do të zhvillohet një konferencë në ambientet e Kuvendit të Shqipërisë, me pjesëmarrje të parlamentarëve të huaj për çështjen e trafikimit të qenieve njerëzore. Është një iniciativë e koleges Gjebrea, për të organizuar një konferencë të tillë, ku kemi pjesëmarrës nga disa parlamente të vendeve, prandaj jeni të ftuar të vini.

Ndërkohë, kolegëve të komisionit, u kujtoj që në datat 2 dhe 3 tetor, sipas asaj që kemi rënë dakord, do të shkojmë në Pogradec dhe Korçë në bashkëpunim me OSBE-në dhe me Komisionin e Veprimtarive Prodhuese për sa i takon krimit mjedisor. Ne kemi planifikuar që gjatë kohës së qëndrimit tonë atje të monitorojmë edhe pikën e kalimit kufitar në Qafë Thanë. Kështu që, ju lutem për të gjitha komunikimet që do të ketë nga ana e stafit të përgjigjeni, në mënyrë që ne ta realizojmë këtë axhendë të monitorimit të të gjithë pikave të kalimit kufitar në vend.

Faleminderit dhe ditën e mirë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

**Sekretar**  
**Pjerin Ndreu**

**Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve**  
**Euzheni Pengili**

**Sekretare e komisionit**  
**Antonela Veshi**